



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
GJYKATA KUSHTETUESE
KOLEGJI I POSAÇËM I APELIMIT

Nr. 6/2021 regjistri (JD)
Datë. 09.07.2021

Nr. 2 i vendimit
Datë 04.10.2021

VENDIM
PËR MOSKALIMIN E ÇËSHTJES
PËR SHQYRTIM NË SEANCË PLENARE

Kolegjit i Shqyrtimit Paraparak, i përbërë nga gjyqtarët:

Ardian Hajdari	Gjyqtar
Ina Rama	Gjyqtare
Rezarta Schuetz	Gjyqtare

– mori në shqyrtim paraparak në dhomë këshillimi, më datë 04.10.2021, në ambientet e Kolegjit të Posaçëm të Apelimit, me Sekretare Gjyqësore Elba Arapi, çështjen e Juridiksionit Disiplinor (JD) nr. 6/2021, datë 09.07.2021, që i përket:

KËRKUES: Tom Dedaj.

OBJEKTI: Rifillimin e gjykimit të çështjes.

BAZA LIGJORE: Neni 300 i Kodit të Procedurës Civile; neni 42 i Kushtetutës së Shqipërisë.

Kolegji i Shqyrtimit Paraparak të kërkesës, pasi dëgjoi gjyqtarin relator Ardian Hajdari, shqyrtoi kërkesën, dokumentet shoqëruese dhe diskutoi çështjen në tërësi,

VËREN:

I. Rrethanat e çështjes

1. Pranë Kolegjit të Posaçëm të Apelimit është administruar kërkesa “Për gjykimin e çështjes së pushuar”, e paraqitur nga Tom Dedaj, me nr. prot. {***}, datë 09.07.2021, me objekt “Rifillimin e gjykimit të çështjes” dhe bazë ligjore nenin 300 të Kodit të Procedurës Civile dhe nenin 42 të Kushtetutës.
2. Në këtë kërkesë drejtuar Kolegjit të Posaçëm të Apelimit, kërkuesi kërkon gjykimin e kërkesëpadisë së çështjes me të paditur ose subjekte të interesuar: *Këshilli i Lartë i Prokurorisë, Prokuroria e Përgjithshme e Republikës së Shqipërisë, Mbledhja e Këshillit të Lartë të Prokurorisë* dhe objekt si më poshtë:
 1. *Deklarimin të paligjshëm dhe shfuqizimin e vendimit nr. 22, datë 28.01.2019, të Këshillit të Lartë të*

Prokurorisë për shkarkimin nga detyra të prokurorit Tom Dedaj.

2. Kthimin e paditësit Tom Dedaj në detyrën e mëparshme të prokurorit, në Prokurorinë e Rrethit Gjyqësor Dibër.

3. Dhënien e pagës paditësit Tom Dedaj nga data 28.01.2019 e në vazhdim.

4. Pezullimin e vendimit të Këshillit të Lartë të Prokurorisë për shkarkimin e paditësit Tom Dedaj deri në përfundimin e gjykimit të kësaj çështjeje.

Me bazë ligjore: nenet 6, 7, 15, 16, 17, 18, 23, 30, 32, 33, 42, 43, 44, 49 e vijues dhe 148/d të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë; nenin 6 të Konventës Evropiane të të Drejtave të Njeriut; nenet 1 dhe 2 të Deklaratës Universale të të Drejtave të Njeriut; nenin 1 të Konventës “Mbi diskriminimin në fushën e punësimit dhe të profesionit”; nenet 31, 32, 41, 42, 153, 154, 324, 327, 328, 329, 331 e vijues të Kodit të Procedurës Civile; nenet 1 e vijues, 9, 10, 11, 12, 13, 14, 15, 16, 18, 20, 22, 44, 46, 47, 49, 51, 55, 56, 58, 60, 61, 80, 81, 82, 83, 85, 93, 105, 108, 115, 116, 118, 121 e vijues, 125 e vijues të Kodit të Procedurës Administrative; Kodin e Punës; nenin 59 të Kodit Penal; nenin 462 të Kodit të Procedurës Penale; nenet 1 e vijues, 111, 115 e vijues, 118 e vijues, 157, 160, 161, 164, 166, 169, 172, 173, 174 të ligjit nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarit dhe prokurorit në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar; nenet 1 e vijues, 26 e vijues, 34 e vijues të ligjit nr. 8737, datë 12.02.2001, “Për organizimin dhe funksionimin e Prokurorisë në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar; ligjin nr. 49/2012 “Për gjykatat administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative”; nenet 276, pika 3 dhe 279, pika 5 e ligjit nr. 115/2015 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”; nenet 1, 3, 4 dhe 5 të ligjit nr. 9367, datë 07.04.2005, “Për parandalimin e konfliktit të interesave në ushtrimin e funksioneve publike”; vendimet e Gjykatës Kushtetuese nr. 34, datë 10.04.2017 dhe nr. 75, datë 19.04.2002; vendimin e Gjykatës Evropiane të të Drejtave të Njeriut të datës 22.09.2012, “Rrapo kundër Shqipërisë”; vendimin unifikues të Gjykatës së Lartë nr. 2, datë 03.01.2014.

– duke i bashkëlidhur kësaj kërkesë dokumentet si më poshtë:

a) Vendimi nr.1, datë 20.07.2020, i Kolegjit të Posaçëm të Apelimit.

b) Shkresë dërguar Kolegjit të Posaçëm të Apelimit, datë 02.06.2021.

c) Shkresë dërguar Kolegjit të Posaçëm të Apelimit, datë 16.06.2021.

- 3.** Gjithashtu, më datë 22.07.2021, Tom Dedaj ka paraqitur kërkesë drejtuar Kolegjit të Posaçëm të Apelimit ku parashtron se më datë 08.07.2021, ka dërguar kërkesë pranë Kolegjit dhe kërkon gjykimin e kërkesë padisë me të dhënat e sipërcituara. Kërkuesi i ka bashkëlidhur kësaj kërkesë kopje të vendimit nr. {***}, datë 18.02.2020, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, me objekt “Zgjidhje martese”.
- 4.** Me shkresën nr. {***}, datë 15.07.2021, me lëndë “Njoftim për përbërjen e trupit gjykues”, Kolegji i Posaçëm i Apelimit ka njoftuar kërkuesin Tom Dedaj për caktimin e anëtarëve të Kolegjit të Shqyrtimit Paraprak të çështjes (JD) nr. 6/2021. Nga verifikimi i shkresës “Dërgim njoftimi” rezulton se kërkuesi ka marrë njoftim, është njohur dhe ka firmosur këtë njoftim më datë 17.07.2021.
- 5.** Pranë Kolegjit të Posaçëm të Apelimit, z. Tom Dedaj ka paraqitur kërkesën me nr. prot. {***}, datë 22.07.2021, me objekt “Përrjashtimin e gjyqtarës Ina Rama nga gjykimi i çështjes” që shqyrton kërkesën me nr. prot. {***}, datë 09.07.2021, të z. Tom Dedaj.
- 6.** Mbledhja e Gjyqtarëve të Kolegjit të Posaçëm të Apelimit, pasi mori në shqyrtim këtë kërkesë, disponoi me vendimin nr. 1, datë 01.10.2021, me mospranimin e kërkesës së z. Tom Dedaj për “Përrjashtimin e gjyqtarës Ina Rama nga shqyrtimi i çështjes”.

II. Vendimmarrja e gjykatave ndaj z. Tom Dedaj

7. Në ngarkim të z. Tom Dedaj, me detyrë prokuror pranë Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Dibër, Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë për Krimet e Rënda, rezultoi të ketë regjistruar procedimin penal nr. {***}, datë 24.10.2016, për veprën penale “Korrupsion pasiv i gjyqtarëve, prokurorëve dhe funksionarëve të tjerë të organeve të drejtësisë”, të parashikuar nga neni 319/ç i Kodit Penal të Republikës së Shqipërisë.
8. Prokurori i Përgjithshëm, me urdhrin nr. 271, datë 31.10.2016, ka vendosur pezullimin e z. Tom Dedaj nga detyra, deri në përfundimin e hetimeve.
9. Gjykata e Shkallës së Parë për Krime të Rënda Tiranë, më datë 26.07.2018, me vendimin nr. {***}, vendosi deklarinin fajtor të kërkuesit për kryerjen e veprës penale të ngarkuar dhe dënimin me 3 (tre) vjet burgim. Në zbatim të neneve 30/1, 35, 44/2 të Kodit Penal, gjykata ka dhënë si dënim plotësues heqjen e së drejtës së kërkuesit për të ushtruar funksione publike për 5 (pesë) vjet, ndërsa në zbatim të nenit 59 të Kodit Penal, ka vendosur pezullimin e dënimit me burgim dhe vënien e të dënuarit në provë për një periudhë 5- (pesë) vjeçare, me kushtin që gjatë kohës së provës të mos kryejë veprë tjetër penale.
10. Gjykata e Apelit për Krime të Rënda Tiranë, më datë 06.11.2018, me vendimin nr. {***}, ka ndryshuar akuzën për kërkuesin, duke vendosur deklarinin fajtor të tij për kryerjen e veprës penale të moskallëzimit të krimit, parashikuar nga neni 300 i Kodit Penal dhe dënimin me 1 (një) vit burgim. Në zbatim të nenit 59 të Kodit Penal, Gjykata e Apelit vendosi pezullimin e dënimit me burgim dhe vënien e kërkuesit në provë për një periudhë 2- (dy) vjeçare, me kushtin që gjatë kohës së provës të mos kryejë veprë tjetër penale. Në aplikim të neneve 30/1, 35/2, 44/2 të Kodit Penal, Gjykata e Apelit ka dhënë si dënim plotësues heqjen e së drejtës për kërkuesin, për të ushtruar funksione publike për 1 (një) vit.
11. Këshilli i Lartë i Prokurorisë, mbështetur në nenin 148/d, pika 2, germa “b” e Kushtetutës, me vendimin nr. {***}, datë 28.01.2019, “Për shkarkimin nga detyra të prokurorit”, ka vendosur shkarkimin e prokurorit Tom Dedaj.
12. Z. Tom Dedaj i është drejtuar Gjykatës Administrative të Apelit, me anë të kërkesëpadisë me objekt:
1. Shfuqizimin e vendimit për shkarkimin nga detyra të prokurorit Tom Dedaj. 2. Kthimin në detyrën e mëparshme të prokurorit në Prokurorinë e Rrethit Gjyqësor Dibër. 3. Dhënien e pagës nga data 28.01.2019 e në vazhdim. 4. Dhënien e një shpërblimi të drejtë në shumën 30.000.000 (tridhjetë milionë) lekë. 5. Konstatimin e diskriminimit ndaj paditësit Tom Dedaj. 6. Anulimin pjesërisht të vendimit të mbledhjes së Këshillit të Lartë të Prokurorisë të datës 19.02.2018, për sa i përket certifikimit, dhënies së mandatit si anëtarë të Këshillit të Lartë të Prokurorisë të anëtarëve G. I., T. B., B. Sh., A. D., A. S., B. C., G. O. dhe N. S. 7. Anulimin pjesërisht të vendimit të Mbledhjes së Këshillit të Lartë të Prokurorisë të datës 19.12.2018, për sa i përket konstituimit të Këshillit të Lartë të Prokurorisë. 8. Pezullimin e vazhdimin të veprimtarisë së Këshillit të Lartë të Prokurorisë deri në përfundimin e procesit gjyqësor. 9. Pezullimin e vendimit të Këshillit të Lartë të Prokurorisë deri në përfundimin e gjykimit të kësaj çështjeje.
13. Gjykata Administrative e Apelit, në përfundim të shqyrtimit gjyqësor të çështjes, me vendimin nr. {***}, datë 22.10.2019, ka vendosur:

- *Shpalljen e moskompetencës funksionale të Gjykatës së Apelit Administrativ, për shqyrtimin e pikave 1, 2, 3 dhe 9 të objektit të kërkesëpadisë së paditësit Tom Dedaj dhe dërgimin e akteve Kolegjit të Posaçëm të Apelimit.*
 - *Shpalljen e moskompetencës funksionale të Gjykatës së Apelit Administrativ, për shqyrtimin e pikave 4, 5, 6, 7 dhe 8 të objektit të kërkesëpadisë së paditësit Tom Dedaj dhe dërgimin e akteve Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë.*
14. Kundër vendimit nr. {***}, datë 22.10.2019, të Gjykatës së Apelit Administrativ, është ushtruar rekurs nga kërkuesi Tom Dedaj. Gjykata e Apelit Administrativ, me vendimin e datës 17.12.2019, bazuar në nenin 13, pika 3 e ligjit nr. 49/2012 “Për organizimin dhe funksionimin e gjykatave administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative”, i ndryshuar, që parashikon se: *Gjykata shpall me vendim moskompetencën e saj për shkaqet e parashikuara në këtë nen dhe urdhëron dërgimin e akteve gjykatës kompetente. Vendimi për shpalljen e moskompetencës dhe vendimi për rrëzimin e kërkesës për shpalljen e moskompetencës ankimohen së bashku me vendimin përfundimtar – ka vendosur mospranimin e rekursit kundër vendimit nr. {***}, datë 22.10.2019, të Gjykatës së Apelit Administrativ.*
15. Gjykata Administrative e Shkallës së Parë Tiranë, me vendimin nr. {***}, datë 09.03.2020, ka vendosur:
- *Të ngrejë përpara Gjykatës së Lartë çështjen e mosmarrëveshjes së kompetencës lëndore dhe funksionale në lidhje me gjykimin e çështjes nr. {***} regj. them., datë ardhje 19.12.2019, me palë ndërgjyqëse: palë paditëse Tom Dedaj, palë e paditur Këshilli i Lartë i Prokurorisë dhe Prokurori i Përgjithshëm*
 - *T’i kërkojë Gjykatës së Lartë që të vendosë si kompetente nga pikëpamja funksionale për gjykimin e kërtimeve “Anulimin pjesërisht të vendimit të Mbledhjes së Këshillit të Lartë të Prokurorisë të datës 19.12.2018, për sa i përket certifikimit, dhënies së mandatit si anëtarë të Këshillit të Lartë të Prokurorisë së anëtarëve G. I., T. B., B. Sh., A. D., A. S., B. C., G. O. dhe N. S.. Anulimin pjesërisht të vendimit të Mbledhjes së Këshillit të Lartë të Prokurorisë të datës 19.12.2018, për sa i përket konstituimit të Këshillit të Prokurorisë. Pezullimin e vazhdimin të veprimtarisë së Këshillit të Lartë të Prokurorisë deri në përfundimin e procesit gjyqësor”, është gjykata Administrative e Apelit Tiranë dhe jo Gjykata Administrative e Shkallës së Parë Tiranë.*
 - *T’i kërkojë Gjykatës së Lartë që të vendosë si kompetente nga pikëpamja lëndore për gjykimin e kërtimeve: “Dhënien e një shpërblimi të drejtë në shumën 30.000.000 lekë; konstatimin e diskriminimit ndaj paditësit Tom Dedaj”, është Kolegji i Posaçëm i Apelimit dhe jo Gjykata Administrative e Shkallës së Parë Tiranë.*
16. Në përfundim të gjykimin, Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë, me vendimin nr. {***}, datë 26.06.2020, në dhomë këshillimi, vendosi:
- a) *Përcaktimin e Gjykatës së Apelit Administrativ si gjykata kompetente për shqyrtimin e kërtimeve të padisë si më poshtë:*
Anulimin pjesërisht të vendimit të Mbledhjes së Këshillit të Lartë të Prokurorisë të datës 19.12.2018, për sa i përket certifikimit, dhënies së mandatit si anëtarë të Këshillit të Lartë të Prokurorisë së anëtarëve G. I., T. B., B. Sh., A. D., A. S., B. C., G. O. dhe N. S.. Anulimin pjesërisht të vendimit të Mbledhjes së Këshillit të Lartë të Prokurorisë të datës 19.12.2018, për sa i përket konstituimit të Këshillit të Prokurorisë. Pezullimin e vazhdimin të veprimtarisë së Këshillit të Lartë të Prokurorisë deri në përfundimin e procesit gjyqësor.

- b) Përcaktimin e Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë si gjykata kompetente për shqyrtimin e kërtimeve të padisë: *Dhënien e një shpërblimi të drejtë në shumën 30.000.000. Konstatimin e diskriminimit ndaj paditësit Tom Dedaj.*
- c) Prishjen e vendimit nr. {***}, datë 22.10.2019, të Gjykatës Administrative të Apelit, lidhur me pjesën e konstatimit të mungesës së kompetencës funksionale për gjykimin e pikave 1, 2, 3 dhe 9 të padisë dhe pushimin e gjykimit të çështjes për këto kërtime të padisë.
17. Kolegji i Posaçëm i Apelit të Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë është vënë në lëvizje pasi Gjykata Administrative e Apelit, në zbatim të vendimit nr. {***}, datë 22.10.2019, ka dërguar për kompetencë pranë Kolegjit aktet e çështjes me paditësit Tom Dedaj.
18. Me vendimin nr. 1 (JD), datë 20.07.2020, Kolegji i Posaçëm i Apelit, pasi mori në shqyrtim në seancë publike kërkesën e z. Tom Dedaj, konstatoi se: [...] *Kërkuesi është njoftuar dhe ka marrë dijeni rregullisht për zhvillimin e seancës plenare publike, por nuk është paraqitur dhe nuk ka depozituar kërkesë për shtyrjen e seancës për ndonjë shkak të arsyeshem. Kolegji, në vijim të situatës faktike si më sipër, çmon se kërkuesi, me mosparaqitjen, ka demonstruar mungesën e vullnetit të tij për t'ia nënshtruar gjykimin e kësaj çështjeje juridiksionit kushtetues të Kolegjit të Posaçëm të Apelit [...] – dhe, në përfundim, mbledhja vendosi: *Pushimin e gjykimit të çështjes nr. 1, datë 19.12.2019, të juridiksionit disiplinor, që i përket ankimit të z. Tom Dedaj kundër Këshillit të Lartë të Prokurorisë dhe Prokurorisë së Përgjithshme.**
19. Më datë 26.02.2021, në Kolegjin e Posaçëm të Apelit është regjistruar çështja nr. 1/2021 (JD), e vënë në lëvizje nga kërkuesi Tom Dedaj, me palë, objekt dhe bazë ligjore sikurse e ka paraqitur fillimisht në Gjykatën Administrative të Apelit. Kolegji i shqyrtimit paraprak, pasi shqyrtoi kërkesën e tij, konstatoi se kjo kërkesë është paraqitur përtej afatit 4-mujor nga konstatimi i cenimit të interesave, bazuar në parashikimet e nenit 71/a, pika 1, germa “b” e ligjit nr. 8577/2000 dhe, në zbatim të dispozitave të nenit 31/a, pika 2, germa “ç” e po këtij ligji, Kolegji çmoi se kërkesa nuk plotëson kriteret ligjore për kalimin për shqyrtim në seancë plenare dhe, me vendimin nr. 1, datë 06.05.2021, vendosi moskalimin e çështjes në seancë plenare.

III. Pretendimet në Kolegjin e Posaçëm të Apelit

20. Në kërkesën drejtuar Kolegjit të Posaçëm të Apelit datë 09.07.2021, kërkuesi Tom Dedaj sqaron se më datë 20.05.2021, është vënë në dijeni të vendimit nr. 1, datë 06.05.2021, të Kolegjit të Posaçëm të Apelit, ku ndër të tjera thuhej se çështja e tij ishte gjykuar më parë nga Kolegji.
21. Për këtë arsye, i është drejtuar me një kërkesë Kolegjit më datë 02.06.2021, ku kërkon t'i vihet në dispozicion një kopje e këtij vendimi, të njëjtën kërkesë e ka përsëritur më datë 26.06.2021 ku, sipas kërkuesit, në të dyja rastet nuk ka marrë përgjigje nga ana e këtij institucioni.
22. Kërkuesi pretendon se vendimi nr. 1, datë 20.07.2020, ka dy të pavërteta dhe, konkretisht, ai nuk është njohur për zhvillimin e asnjë seance të Kolegjit dhe nuk ka paraqitur ndonjë kërkesë, aq më tepër për pushimin e gjykimit. Kërkuesi, bazuar në nenin 300 të Kodit të Procedurës Civile, “Efektet juridike të pushimit të çështjes”, kërkon nga Kolegji gjykimin e çështjes me objekt dhe palë si ato të përcaktuara në pikën 2 të këtij vendimi.

23. Kërkuesi thekson në kërkesë se Kolegji i Posaçëm i Apelimit është kolegji pranë Gjykatës Kushtetuese dhe në rastin e shqyrtimit të ankimit të masave disiplinore ndaj magistratëve, ka juridiksion fillestar dhe duhet t'i shqyrtojë këto lloj çështjesh si Gjykatë e Shkallës së Parë, duke u bazuar në Kodin e Procedurës Administrative dhe në Kodin e Procedurës Civile dhe jo si Gjykatë Kushtetuese e mirëfilltë.
24. Në përfundim, kërkuesi kërkon gjykimin e kërkesëpadisë së tij sipas urdhërimeve të Gjykatës Administrative të Apelit Tiranë duke miratuar të gjitha kërkesat e paraqitura në objektin e kërkesëpadisë, dhe konkretisht:
1. *Deklarimin të paligjshëm dhe shfuqizimin e vendimit nr. {***}, datë 28.01.2019, të Këshillit të Lartë të Prokurorisë për shkarkimin nga detyra të prokurorit Tom Dedaj.*
 2. *Kthimin e paditësit Tom Dedaj në detyrën e mëparshme të prokurorit, në Prokurorinë e Rrethit Gjyqësor Dibër.*
 3. *Dhënien e pagës paditësit Tom Dedaj nga data 28.01.2019 e në vazhdim.*
 4. *Pezullimin e vendimit të Këshillit të Lartë të Prokurorisë për shkarkimin e paditësit Tom Dedaj deri në përfundimin e gjyqimit të kësaj çështjeje.*
25. Kërkuesi Tom Dedaj, pas regjistrimit të kërkesës objekt gjykimi [datë 09.07.2021], ka dorëzuar përsëri më datë 22.07.2021 të njëjtën kërkesë pranë Kolegjit, por duke i bashkëlidhur kësaj here: 1. kopje të vendimit nr. {***}, datë 18.02.2020 të Gjykatës së Shkallës së Parë Tiranë, me objekt “Zgjidhje martesë”, ku kjo gjykatë ka vendosur zgjidhjen e martesës midis palëve Mimoza Dedaj dhe Tom Dedaj; 2. kopje të kërkesave drejtuar Kolegjit me objekt “marrje informacioni, dokumentesh e aktesh”.

IV. Vlerësimi i kërkesës nga Kolegji i Shqyrtimit Paraprak

A. Për legjitimitetin e kërkuesit dhe Kolegjit të Posaçëm të Apelimit

Kolegji i Shqyrtimit Paraprak fillimisht saktëson se ankimi kushtetues individual, në çdo rast, duhet të plotësojë kriteret e nenit 71/a të ligjit nr. 8577/2000, që lidhen me shterimin e mjeteve juridike, afatin e paraqitjes së kërkesës, pasojat negative të pësuar në mënyrë të drejtpërdrejtë e reale, mundësinë për rivendosjen e së drejtës së shkelur, si dhe rregullimet e veçanta ligjore të shqyrtimit paraprak të kërkesës.

26. Në kuadër të juridiksionit disiplinor, e konkretisht nenit 179, pika 7, rezulton se: [...] *Kolegji i Apelimit shqyrton ankimet ndaj vendimeve të Këshillit të Lartë Gjyqësor, Këshillit të Lartë të Prokurorisë dhe Inspektorit të Lartë të Drejtësisë për vendosjen e masave disiplinore, përkatësisht ndaj gjyqtarëve, prokurorëve dhe inspektorëve të tjerë [...], si dhe referuar më tej në nenin 5, pika 3 e ligjit nr. 84/2016 “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, sipas të cilit: [...] 3. Kolegji i Apelimit gjatë mandatit të tij, në përputhje me Kushtetutën, ligjin “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese” dhe legjislacionit që rregullon çështjet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë, ka juridiksion të shqyrtojë: [...] b) ankimet kundër vendimeve të Këshillit të Lartë Gjyqësor, Këshillit të Lartë të Prokurorisë dhe Inspektoratit të Lartë të Drejtësisë për vendosjen e masave disiplinore ndaj gjyqtarëve, prokurorëve dhe inspektorëve të tjerë.*

Në zbatim të këtyre dispozitave, Kolegji ka juridiksion për shqyrtimin e kërkesës së kërkuesit pasi kundër vendimit të Këshillit të Lartë të Prokurorisë për masën disiplinore të shkarkimit, mund të ushtrohet ankim në Kolegjin e Posaçëm të Apelimit.

27. Në nenin 3, pika 1 e ligjit nr. 8577, datë 10.02.2000, “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese”, i ndryshuar, parashikohet se *kërkesa shqyrtohet paraprakisht nga Kolegji, i përbërë nga tre gjyqtarë të Gjykatës Kushtetuese, ku bën pjesë dhe relatori*. Kërkesa e paraqitur nga kërkuesi Tom Dedaj është shortuar pranë këtij Kolegji më datë 09.07.2021, ku është caktuar dhe trupa gjyqësore për shqyrtimin paraprak.
28. Nga verifikimi i kërkesës së paraqitur në Kolegj rezulton se ajo është firmosur nga vetë z. Tom Dedaj, ndaj të cilit Këshilli i Lartë i Prokurorisë ka vendosur dhënien e masës disiplinore për shkarkimin nga detyra, në këtë mënyrë kërkuesi legjitimohet *ratione personae*.
29. Një kusht tjetër paraprak për shqyrtimin e ankimit kushtetues individual në kuptim të nenit 131, pika 1, shkronja “f” e Kushtetutës dhe nenit 71/a të ligjit nr. 8577/2000, lidhet me përmbajtjen e pretendimeve (*ratione materiae*). Nga verifikimi i dokumentacionit, Kolegjit i rezultoi se kërkuesi ka paraqitur “kërkesën për gjykimin e çështjes së pushuar”, me objekt “Rifillimin e gjykimit” dhe me bazë ligjore nenin 42 të Kushtetutës dhe nenin 300 të Kodit të Procedurës Civile. Kolegji konstaton se në faqen e dytë të kërkesës, z. Dedaj ka ripërsëritur të njëjtën kërkesë padi, me palë, objekt dhe bazë ligjore të njëjtë me atë që ka paraqitur më datë 26.02.2021 në Kolegjin e Posaçëm të Apelit, nga ku rezulton se ka një vendimmarrje nga ana e Kolegjit mbi këtë kërkesë. Konkretisht, me vendimin nr. 1, datë 06.05.2021, Kolegji ka arritur në përfundimin se kërkesa nuk plotëson kriteret ligjore për kalimin për shqyrtim në seancë plenare dhe ka vendosur moskalimin e çështjes në seancë plenare.

B. Mbi pretendimet e kërkuesit

30. Kolegji i Shqyrtimit Paraprak, pasi u njoh me pretendimin e kërkuesit për mosdijeni të zhvillimit të gjykimit të çështjes së tij dhe vendimit nr.1, datë 20.07.2020, të Kolegjit, konstaton se ky pretendim i kërkuesit nuk qëndron. Nga verifikimi i dokumentacionit, rezulton se kërkuesi është vënë në dijeni që çështja gjyqësore e tij i ka kaluar për kompetencë Kolegjit të Posaçëm të Apelit që me dhënien e vendimit nr. {***}, datë 22.10.2019, të Gjykatës së Apelit Administrativ, ndaj të cilit kërkuesi ka bërë rekurs në Gjykatën e Lartë, duke kërkuar ndryshimin e vendimit të sipërcituar dhe gjykimin e çështjes po nga Gjykata e Apelit Administrativ, por me një tjetër trup gjykues dhe vazhdimin e gjykimit të kësaj çështjeje.
31. Kolegji, në kuadër të informimit dhe transparencës të veprimtarisë së tij, nga momenti i regjistrimit të kësaj çështjeje të juridiksionit disiplinor, ka publikuar në faqen zyrtare në internet të tij të dhënat e çështjes, palët e interesuara, përbërjen e Kolegjit të Shqyrtimit Paraprak të kërkesës, datën e zhvillimit të seancës publike, statusin e procedurës së çështjes dhe në fund është publikuar si vendimi nr. 1, datë 20.07.2020, ashtu edhe vendimi nr. 1, datë 06.05.2021, i Kolegjit për Shqyrtimin Paraprak të saj.
32. Lidhur me pretendimin e kërkuesit se nuk ka paraqitur ndonjë kërkesë për pushimin e gjykimit, sqarojmë se Kolegji i Posaçëm i Apelit i Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë, me vendimin nr. 1, datë 20.07.2020, ka arritur në përfundimin se *kërkuesi Tom Dedaj, edhe pse ka pasur dijeni për shqyrtimin e çështjes në Kolegj, që prej kalimit të saj për kompetencë nga Gjykata e Apelit Administrativ, nuk ka paraqitur kërkesën apo parashtrime me shkrim në lidhje me objektin e gjykimit dhe pretendimet e tij.*

Kërkuesi është njoftuar dhe ka marrë dijeni rregullisht për zhvillimin e seancës plenare publike, por nuk është paraqitur dhe nuk ka depozituar kërkesë për shtyrjen e seancës për ndonjë shkak të arsyeshëm. Kolegji, në vijim të situatës faktike si më sipër, çmon se kërkuesi, me mosparaqitjen, ka demonstruar mungesën e vullnetit të tij për t'ia nënshtruar gjykimin e kësaj çështjeje juridiksionit kushtetues të Kolegjit të Posaçëm të Apelimit, për pasojë ky vlerësim i parë lidhur edhe me mungesën e një akti formal drejtuar Kolegjit, i shpjeguar më lart se ka ndodhur për shkaqe të ndërvarura nga zgjedhjet procedurale të subjektit dhe vendimit të Gjykatës së Apelit Administrativ, e çon Kolegjin në përfundimin se situata faktike e përshkruar duhet të trajtohet si një heqje dorë nga kërkesa, në kuptim të parashikimit në nenin 31/b, pika 1 e ligjit nr. 8577/2000.

33. Kolegji i Shqyrtimit Paraprak konstaton se pretendimi i kërkuesit se nuk ka marrë përgjigje nga ana e Kolegjit për shkresat e tij me objekt marrje aktesh dhe dokumentacioni, nuk qëndron. Me shkresën nr. {***} prot., datë 09.10.2020, Kolegji i ka kthyer përgjigje kërkuesit duke i vënë në dispozicion procesverbale të seancave në dhomë këshillimi, si dhe vendimin e datës 03.02.2020 “Për kalimin e çështjes për shqyrtim paraprak, mbledhjes së gjyqtarëve”. Gjithashtu, me shkresën nr. {***} prot., datë 09.06.2021, Kolegji i ka kthyer përgjigje kërkesës së tij të datës 03.06.2021, duke i bërë me dije kërkuesit se i janë vënë në dispozicion aktet dhe vendimet e marra nga Kolegji ndaj z. Tom Dedaj. Rezulton se dhe me shkresën nr. {***} prot., datë 25.06.2021, Kolegji i ka kthyer përgjigje shkresës së kërkuesit të datës 16.06.2021, duke i sqaruar atij se është mbajtur korrespondencë administrative me të, si dhe i janë vënë në dispozicion aktet procedurale në lidhje me çështjen objekt shqyrtimi në adresat e deklaruara nga ana e kërkuesit. Në përmbledhje të sa më sipër, në kushtet kur Kolegji ka shkëmbyer shkresa dhe përgjigje me kërkuesin të paktën tri herë në harkun kohor prej më shumë se gjashtë muajsh, ky pretendim i kërkuesit rezulton i pabazuar në fakte.
34. Lidhur me sugjerimin e kërkuesit se Kolegji duhet t'i gjykojë këto çështje (masat disiplinore ndaj magjistratëve) si gjykatë e shkallës së parë, duke u bazuar në Kodin e Procedurës Administrative dhe në Kodin e Procedurës Civile dhe jo si Gjykatë Kushtetuese e mirëfilltë, Kolegji i Shqyrtimit Paraprak sjell në vëmendje se dispozitat që rregullojnë veprimtarinë e Kolegjit të Posaçëm të Apelimit në kuadër të juridiksionit disiplinor, konkretisht neni 179, pika 7 e Kushtetutës, parashikon se: [...] *Kolegji i Apelimit shqyrton ankimet ndaj vendimeve të Këshillit të Lartë Gjyqësor, Këshillit të Lartë të Prokurorisë dhe Inspektorit të Lartë të Drejtësisë për vendosjen e masave disiplinore, përkatësisht ndaj gjyqtarëve, prokurorëve dhe inspektorëve të tjerë [...].* Ky parashikim kushtetues është detajuar më tej në nenin 5, pika 3 e ligjit nr. 84/2016 “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, sipas të cilit: *Kolegji i Apelimit gjatë mandatit të tij, në përputhje me Kushtetutën, ligjin “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese” dhe legjisllacionin që rregullon çështjet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë, ka juridiksion të shqyrtojë: a) shkeljet disiplinore të anëtarëve të Gjykatës Kushtetuese, të Këshillit të Lartë Gjyqësor, Këshillit të Lartë të Prokurorisë, Prokurorit të Përgjithshëm dhe Inspektorit të Lartë të Drejtësisë; b) ankimet kundër vendimeve të Këshillit të Lartë Gjyqësor, Këshillit të Lartë të Prokurorisë dhe Inspektoratit të Lartë të Drejtësisë për vendosjen e masave disiplinore ndaj gjyqtarëve, prokurorëve dhe inspektorëve të tjerë.*

Neni 192, pika 1 e ligjit nr. 115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë” parashikon se: *Përveçse kur parashikohet ndryshe në këtë ligj, ndaj aktit administrativ individual të Këshillit, mund të bëhet ankim në Gjykatën e Apelit Administrativ. Aktet administrative individuale që vendosin masë disiplinore mbi prokurorët, ankimohen në Gjykatën Kushtetuese.*

Në këtë kuptim, në zbatim të përcaktimeve të nenit 179/b, pika 5 e Kushtetutës, Kolegji i Posaçëm i Apelit vepron nën kornizën ligjore të Gjykatës Kushtetuese, si një nga dy kolegjet e kësaj gjykate. Për rrjedhojë, procedura për vlerësimin e kërkesës së kërkuarit dhe shqyrtimi i saj do të bëhet bazuar në parashikimet e ligjit nr. 8577, datë 10.02.2000, “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar.

35. Për sa i përket kërimit nga z. Tom Dedaj për gjykimin nga Kolegji të kërkesëpadisë së tij sipas urdhërimeve të Gjykatës Administrative të Apelit Tiranë, Kolegji i Shqyrtimit Paraprak konstaton se kërkuari i është drejtuar edhe më parë Kolegjit me kërkesë me të njëjtin objekt, për të cilën, me vendimin nr. 1, datë 06.05.2021, është vendosur moskalimi për shqyrtim në seancë plenare, me arsyetimin se kërkuari nuk ka respektuar afatin 4-mujor të ankimit, të parashikuar në ligjin organik të Gjykatës Kushtetuese.
36. Në kërkesën e datës 09.07.2021, drejtuar Kolegjit me të njëjtin objekt dhe palë si në kërkesën e mëparshme, kërkuari, me përjashtim të pretendimit se nuk ka marrë njoftim për zhvillimin e gjyimit të çështjes ndaj tij në Kolegj, pretendim i pabazuar tashmë sipas argumentimit të sipërcituar në këtë vendim, nuk ka parashtruar asnjë shkak të ri apo argument shtesë për të provuar bazueshmërinë e pretendimeve të tij. Kolegji konstaton sërish si në vendimin nr. 1, datë 06.05.2021, se kërkuari Tom Dedaj ka zgjedhur përsëri mjetin e gabuar procedural, duke kërkuar të gjykohet “kërkesëpadi”, ndërkohë që sipas kërkesave të nenit 27 të ligjit nr. 8577, datë 10.02.2000, “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, duhej drejtuar me “kërkesë” sipas kushteve dhe rrethanave të parashikuara në këtë ligj.
37. Neni 132 i Kushtetutës parashikon se vendimet e Gjykatës Kushtetuese kanë fuqi detyruese të përgjithshme dhe janë përfundimtare, neni 72, pika 7 e ligjit për Gjykatën Kushtetuese shprehet se: *Vendimi i Gjykatës Kushtetuese ka fuqi detyruese të përgjithshme dhe është përfundimtar.* Në këtë kuptim, vendimi nr. 1, datë 06.05.2021, i Kolegjit të Posaçëm të Apelit, me të cilin është mbajtur një qëndrim përfundimtar lidhur me kërkesën e paraqitur nga z. Tom Dedaj, nuk mund të vihet më në diskutim nga kjo Gjykatë dhe ai, gjithashtu, përbën pengesë në aspektin kushtetues për të marrë në shqyrtim të njëjtën kërkesë, të paraqitur sërish në Kolegj nga kërkuari. Në vendimin e saj nr. 23, datë 08.06.2007, Gjykata Kushtetuese ka pranuar ndër të tjera se [...] *siguria juridike nënkupton që në rastet kur gjykata ka vendosur përfundimisht për një çështje, vendimi i saj nuk duhet të vihet në dyshim [...].* Për pasojë, në këto kushte, Kolegji vlerëson se gjykimi kushtetues nuk mund të vihet në lëvizje.
38. Kolegji i Shqyrtimit Paraprak vlerëson se pretendimet e kërkuarit janë të pabazuara dhe, për rrjedhojë, kërkesa e paraqitur prej tij nuk mund të kalojë për shqyrtim në seancë plenare, pasi nuk i përmbush standardet e ankimit individual për gjykimin e kushtetutshmërisë së një akti. Kolegji konstaton gjithashtu sërish se pretendimi i kërkuarit lidhet me kundërshtimin e një vendimi të Këshillit të Lartë të Prokurorisë

që është marrë më datë 28.01.2019, kompetencën për shqyrtimin e të cilit e ka Kolegji i Posaçëm i Apelit, dhe kërkuesi për këtë fakt është në dijeni, së paku që me vendimin e Gjykatës së Lartë nr. {***}, datë 26.06.2020 dhe, për pasojë, duket se kërkesat e tij, drejtuar Kolegjit të Posaçëm të Apelit, janë abuzive dhe të pambështetura në ligj.

39. Në përmbledhje të sa më sipër, Kolegji, bazuar në parashikimet e nenit 31, pika 3 e ligjit nr. 8577, datë 10.02.2000, “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese”, i ndryshuar, dhe në zbatim të dispozitave të nenit 31/a, pika 2, germa “dh” e po këtij ligji çmon se kërkesa nuk plotëson kriteret ligjore për kalimin për shqyrtim në seancë plenare. Konkretisht, këto dy dispozita ligjore përcaktojnë shprehimisht se:

[...] Kur kërkesa nuk përmbush kriteret e parashikuara në nenin 31/a, pika 2 e këtij ligji, Kolegji vendos moskalimin e çështjes në seancë plenare [...].

[...] kërkimet e paraqitura në kërkesë janë objekt i një vendimi të mëparshëm të Gjykatës Kushtetuese, ose rivendosja në vend e së drejtës së shkelur nuk është e mundur [...].

PËR KËTO ARSYE,

Kolegji i Shqyrtimit Paraprak të kërkesës, bazuar në nenin 31, nenin 31/a, pika 2, germa “dh” e ligjit nr. 8577, datë 10.02.2000, “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar,

VENDOSI:

Moskalimin e çështjes për shqyrtim në seancë plenare.

Tiranë, më 04.10.2021.

Ina RAMA

Ardian HAJDARI

Rezarta SCHUETZ

ANËTARE

ANËTAR

ANËTARE

nënshkrimi

nënshkrimi

nënshkrimi